



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivery	12 - 12 2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHKURTUK	7418/2023		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1264/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1264/2023 të datës 09.10.2023 të parashtruar nga ankuesja

kundër Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës si dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "Kompensim Material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 11.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet t si e bazuar ankesa me numër A.nr.1264/2023 e datës 09.10.2023 e parashtruar nga ankuesja

II. Detyrohet Njësia e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që ankueses t'ia bëjë kompensimin në mënyrë retroaktive të pagave të papaguara për muajt janar, shkurt, mars, prill dhe maj të vitit 2023, duke e zbritur nga vlera e përgjithshme shumë e paguar tashmë në vlerë prej (1,442.19€).

III. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi si në pikën II të dispozitiv në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

Ar sy e t i m

Ankuesja më datë 09.10.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 6468/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës si dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme për shkak të heshtjes lidhur me mos kompensimin e saj me rastin e transferimit për shkak të ristrukturimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me pretendimin ankimor se e njëjta nuk është kompensuar me pagë të plotës sikurse përcaktohet me dispozitat e ligjit material, për muajt, janar, shkurt, mars, prill dhe maj të vitit 2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 12.10.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Ndërsa Këshilli më datë 13.10.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin me numër VK/2023 të datës 22.11.2022 ka vazhduar afatin për vendimmarrje edhe për 10 ditë pune lidhur me ankesën A.nr.1264/2023 të parashtruar nga ankuesja

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 6468/2023 të datës 09.10.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin e DMZP-së të datës 11.01.2023; Aktin e Emërimit të datës 10.09.2019; E-mailin e datës 12.01.2023 dërguar nga Arkiva MPB për ankuesen; E-mailin e datës 23.01.2023 dërguar nga Sh.A për ankuesen; E-mailin e datës 27.01.2023 dërguar nga ankuesja për K.K; E-mailin e datës 31.01.2023 dërguar nga ankuesja për H.K me korrespondencën e bashkangjitur; Kërkesën e ankueses të datës 20.02.2023; Vendimin e DMZP-së të datës 15.03.2023; E-mailin e datës 16.03.2023 dërguar nga R.Z për A.S; Kërkesën e ankueses të datës 16.03.2023 dërguar për B.B; Kërkesën e ankueses të datës 17.03.2023 dërguar për B.B me korrespondencën e bashkangjitur; Pasqyra e llogarisë së trustit e datës 30.06.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 10.10.2023; Përgjigjen e datës 13.10.2023; Shkresë ë pagesave me lista të pagave e datës 12.10.2023; Raportin e datës 01.11.2023; Vendimin e Këshillit A.nr.991/2022; Vendimin e Këshillit A.nr.95/2023; Vendimin e DMZP-së të datës 02.06.2023; E-mailin e datës 07.12.2023 të Njësisë së Burimeve Njerëzore të MMPHI; E-mailin e ankueses të datës 12.10.2023 dërgura për Këshill; Akt emërimit e ankueses të datës 01.06.2023; E-mailin e datës 12.10.2023 dërguar nga V.B për Këshillin; E-mailin e datës 12.10.2023 dërguar nga Këshilli për ankuese.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë dhe ka konstatuar se ankesa e ankueses është e *bazuar*, sepse:

Para se të lëshohet në shqyrtim meritor Kolegji i Këshillit ka analizuar elementet e pranueshmërisë së ankesës së ankueses në kuptim të respektimit të afateve ankimore, dhe duke marr për bazë nenin 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenin 87 të Ligjit Nr.03/L-212 i Punës, ka ardhur në përfundimin se

ankuesja ankesën e ka parashtruar brenda afateve të përcaktuara kundër heshtjes administrative pasi që e njëjta i është drejtuar Drejtori të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik me datë 25.07.2023 me kërkesën dhe njoftimin se e njëjta nuk është duke u kompensuar, si dhe afatit të parashkrimit të kërkesave nga marrëdhënia e punës në para, nga rrjedh se pretendimi i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës se ankuesja ankesën e ka parashtruar jashtë afatit është i paqëndrueshëm.

Nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë së me Vendimin Nr.214/2022 të datës 01.02.2022 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës është miratuar Rregullorja Nr.01/2022 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, e publikuar me datë 01.02.2022 në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, me ç'rast si rezultat i bashkimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Diasporës ka pas shuarje të disa pozitive si dhe ndryshime në përshkrimin e detyrave dhe kriterëve për pozita të caktuara. Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë me Vendimin V.nr.1/KR/2022 të datës 24.02.2022, ka themeluar Komisionin e Ristrukturimit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (tutje referuar Komisioni i Ristrukturimit), kurse, me Vendimin me shenjë VPD Nr.01/2022 të datës 16.03.2022 ka miratuar përshkrimin e detyrave të punës të nivelit të mesëm dhe të ulët drejtës të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Me tej nga shqyrtimi i shkresave të lëndës rrjedhë së ankuesi ankuesja sipas Aktit të Emërimit të datës 10.09.2019 ka qenë e emëruar në pozitën Drejtore e Departamentit për Ruajtjen dhe Kultivimin e Arsimit dhe Kulturës në Diasporë në ish Ministrinë e Diasporës dhe Investimeve Strategjike e cila më herët ishte bashkuar më Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, kurse me miratimin e rregullores së re gjegjësisht me Rregulloren Nr.01/2022 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës pozita e punës të cilin e ka mbajtur ankuesja sipas akt emërimit të datës 10.09.2019 është shuar.

Tutje, Komisioni i Ristrukturimit duke vepruara sipas dispozitave të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, ka hartuar Raportin e veçantë të punës me datë 01.11.2022 më shifër:1620 përmes të cilit ishte arritur në përfundimin me propozimin që ankuesja të sistemohet në pozitën Udhëheqëse e Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, kurse Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik me datë 11.01.2023 ka nxjerrë Vendimin me shifër Nr.150/2023 përmes të cilit ankuesen e ka transferuar në pozitën Udhëheqëse e Autoriteti Rajonal të Pellgjeve Lumore në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Ankuesja, kundër Vendimin me shifër Nr.150/2023 të datës 11.01.2023 kishte parashtruar ankesë në Këshill, ndërsa me datë 03.03.2023 Këshilla ka nxjerrë Vendimin A.nr.95/2023 me numër protokoli:2396/2023 përmes të cilit e refuzon ankesën e ankueses të datës 19.01.2023, ndërsa e lënë në fuqi Vendimin me shifër Nr.150/2023 të datës 11.01.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, mirëpo Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik përmes vendimit të datës 15.03.2023 me shifër:415/02 e kishte shfuqizuar vendimin paraprak Vendimin me shifër Nr.150/2023 të datës 11.01.2023 përmes të cilit ankuesja ishte transferuar në pozitën Udhëheqëse e Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me theksin që barra e pasojave juridike

bie mbi institucionin ku ishte emëruar ankuesja, respektivisht mbi Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Lidhur me vendimmarrjen e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik sipas vendimit të datës 15.03.2023 me shifër:415/02, Kolegji analizoi dispozitat e nenit 53 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që ka kompetenca të nxjerrë aktin, nga organi i tij mbikëqyrës apo nga një organ tjetër i përcaktuar shprehimisht me ligj”* dhe nenit 130 paragrafi 1 ndërlidhur me nenin 144 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i të njëjtit ligj ku përcaktohet se: *“130.1. Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, parashtrimi i një ankese pezullon, sipas fuqisë së ligjit, prodhimin e pasojave juridike të aktit administrativ, deri në njoftimin e vendimit që zgjidh ankesën dhe 144.1.Një akt administrativ do të bëhet i ekzekutueshëm me: 1.1. skadimin e afatit për ankesën kundër tij, nëse një ankese e tillë nuk është parashtruar”* dhe ka ardhur në përfundimin se është në kompetencë të organit publik që ka nxjerrë aktin sipas detyrës zyrtare edhe ta ndryshojë apo shfuqizojë të njëjtin sikurse në rastin konkret kur është vepruar përmes Vendimit të datës 15.03.2023 me shifër:415/02 nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik kur e ka shfuqizuar Vendimin e datës 11.01.2023, mirëpo pika 2 e dispozitivit Vendimit të datës 15.03.2023 me shifër:415/02 nuk është e ligjshme ngase ankuesja kundër Vendimit të datës datës 11.01.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik kishte parashtruar ankese në Këshill dhe duke marr parasysh faktin se ankesa sipas fuqisë së ligjit pezullon sipas fuqisë së ligjit prodhimin e pasojave juridike të aktit administrativ i njëjti s’ka mundur të ekzekutohet dhe rrjedhimisht nuk mund të ngarkosh me barrë të pasojave juridike si në rastin konkret Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Tutje, Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik me datë 02.06.2023 ka nxjerrë Vendimin me shifër:910 përmes të cilit ankuesen e ka transferuar në pozitën Drejtor i Departamentit për Shërbimet e Menaxhimit të Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kurse kjo e fundit me qëllim të zbatimit të vendimit të DMZP-së me datë 02.06.2023 i lëshon ankueses Aktin e Emërimit duke e sistemuar në pozitën e punës Drejtor i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme dhe atë me datë efektive nga 05.06.2023.

Lidhur me kërkesën për kompensim material, Këshilli me datë 13.10.2023 ka pranuar prova nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të MPJD-së dhe ka konstatuar se ankuesja sipas listës së pagave për muajt në vijim, respektivisht për muajin janar ankuesja ka realizuar pagë në vlerë prej 242.12€/neto, në muajin shkurt ka realizuar pagë në vlerë prej 955.26€/neto, në muajin mars ka realizuar pagë në vlerë prej 244.81€/neto, të dhëna këto të cilat i deklaroi edhe ankuesja sipas shumave të ngjashme, andaj bazuar në këto të gjetura del se ankueses i është mohuar e drejta në pagë pavarësisht se me dispozitat e Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil neni 16 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: *“Nëpunësi i transferuar në pozitën e të njëjtit kategori që ka qene, për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, e merr pagën e pozitës që është transferuar. 2. Deri në momentin e përfundimit të procedurës së transferimit sipas nenit 15 të kësaj Rregulloreje, nëpunësi civil merr pagën e njëjtë që e ka pasur para përfundimit të transferimit”*, ngase ankuesja përpara se të transferohet ka mbajtur pozitë të mesme drejtuese, respektivisht pozitë të Drejtorit të Departamenti gjegjësisht edhe me rastin e transferimit është sistemuar në pozitë të Drejtorit të Departamenti, nga rrjedh se paga në muajin janar nuk i është bërë në ekuivalencë me koeficientin sipas ligjit paraprak të pagave, dhe po ashtu edhe për muajit pasues nga muaji shkurti deri në muajin maj pagesat nuk korrespondojnë me ekuivalencën e koeficientit sipas ligjit



të ri të pagave, kurse akti përmes të cilit ankuesja është transferuara paraprakisht kanë qenë të goditur me ankesa në Këshill, nga rrjedh se të njëjtit iu është pezulluar sipas fuqisë së ligjit efekti i prodhimit të pasojave juridike, kurse barra e përgjegjësisë financiare bie mbi institucionin ku ankuesja ka qenë duke punuar deri me rastin e transferimit në MKRS, me datë 02.06.2023.

Prandaj, nga se u tha si më lartë, ankuesja për periudhën kohore janar-maj 2023 ka realizuar të hyra në vlerën e përgjithshëm prej 1,442.19€, veprim ky në kundërshtim me dispozitat e nenit 16 të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil dhe nenit 8 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ashtu që Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës detyrohet t'ia bëjë kompensim në mënyrë retroaktive të pagave të papaguara ankueses, duke bërë kalkulimin e përgjithshëm të pagave për ankuesen për muajt, janar, shkurt, mars, prill dhe maj 2023, ashtu që shumës së përgjithshme të fituar për muajt e cekur duhet t'ia zbresë shumën që ankuesja tashmë e ka të realizuar (1,442.19€), nga rrjedh se diferenca në mes të shumës së paguar dhe shumës së përgjithshme të pagave për muajt janar, shkurt, mars, prill, maj 2023 mbetet detyrimi që Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ka ndaj ankueses duke përfshirë edhe pagesën e trustit sipas legjislacionit të aplikueshëm lidhur me periudhën e kontestuar.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1264/2023

Elakron GASHI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetari i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ;
- Arkivitet të KPMShCK-së